



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 123 dt.30.07.1996

Mbështetur në ligjin Nr.7542, dt.23.12.1992 “Mbi privatizimin e banesave shtetërore”, në V.K.M. Nr.527, 528, 530, dt.17.10.1994, në V.K.M. Nr.460e 49, dt.29.01.1993 si dhe në ligjin Nr.7572, dt.10.05.1992, neni.14 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal” pasi u shqyrtua problemi i shpërndarjes së apartamenteve të bllokut Sizmik, u vendos për kriteret e shpërndarjes.

VENDOSI

1. Kriteret e ndarjes së pallatit janë si më poshtë :
 - 1.Qytetarët që propozohen nga Fabrika e Tullave të Vorës, e cila ka Akt – Marrëveshje me Pushtetin Lokal.
 - 2.Të respektojë vendimet e Këshillit Bashkiak të marra para disa kohësh për disa qytetarë që janë në procedurë për strehim.
 - 3.Qytetarë me Akt – Marrëveshje shpronësimi me Pushtetin Lokal.
 - 4.Qytetarët me vendim gjykate.
 - 5.Të pastrehë të tjerë.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni i Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA